



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORATI PËR ARSIM
Dt. 19.06.2020, Nr., 09.111.21047



Në vështrim të nenit 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Drejtori i Drejtoratit për Arsim, shpallë:

K O N K U R S

1. Një shtepiak(fokist) në SHML"GJ.K.Skënderbeu"-Drenas.
2. Një shtepiak(fokist) në SHMP"Fehmi Lladrovci"- Drenas.
3. Një shtepiak(fokist) në SHFMU"Hasan Prishtina"-Llapushnik.
4. Një rojtar në SHFMU " 24 Korriku " – Fushticë e Poshtme.

KRITERET E PUNËSIMIT PËR PUNËTOR TEKNIKO – SHËRBYES:

- Shkolla e mesme

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:

1. Aplikacioni i punësimit.
2. Diploma origjinale, ose e vërtetuar në Komunë apo të Noteri publik.
3. Çertifikatë origjinale që nuk është nën hetime, jo më e vjetër se gjashtë muaj.
4. Kopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim ose patentë shoferi)

REKRUTIMI:

Intervistimin dhe përzgjedhjen e kandidateve do ta bëjë komisioni i DKA-së. Në intervistë do të ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e këtij konkursi. Kandidati i cili përzgjidhet nga komisioni intervistues obligohet që brenda afatit të ankesave ta sjellë në DKA çertifikatën mjekësore për gjëndjen shëndetsore lidhur me çështjen e punësimit, në të kundërtën do të nënshkruhet kontrata e punës me kandidatin e dytë më radhë për të cilin vlen e njëjta rregullë.

VËREJTJE:

Aplikacioni për konkurim merret në zyrat e DKA-së, të plotësohet rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe me shkronja të mëdha të shtypit, Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Arkivin Komunal, ndërsa dokumentet e pakompletuara, ato që arrijnë pas afatit të konkurrimit dhe dokumentet shtesë jashtë dorëzimit në arkiv nuk pranohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Drenas,
Më:19.06.2020

